



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

Numri: KSC-BC-2020-05
Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës

Vendos: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatësi Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Pjesëmarrësi parashtrues: Prokurori i Specializuar

Datë: 20 nëntor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Parashtrime të Prokurorisë mbi rishikimin e paraburgimit

Zyra e Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të të akuzuarit

Julius von Bóné

A. HYRJE

1. Në përputhje me nenin 41(6) dhe (10) të Ligjit¹ dhe rregullën 57(2) të Rregullores,² dhe në zbatim të vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake,³ Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) paraqet këto parashtrime mbi rishikimin e paraburgimit të Salih MUSTAFËS (“i akuzuari”).
2. Më datë 14 shkurt 2020, ZPS-ja kërkoi konfirmimin e Aktakuzës kundër të akuzuarit dhe lëshimin e një fletarrestimi për të (“kërkesa për fletarrestim”).⁴ Më 12 qershor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e miratoi kërkesën për fletarrestim, duke konstatuar se ekzistonte dyshimi i bazuar mirë se i akuzuari kishte kryer vepra penale që bien në juridiksionin e Dhomave të Specializuara të Kosovës (“DHSK”)⁵ dhe duke konstatuar se ekzistonin arsye të artikulueshme për të besuar se ekzistonte rreziku i arratisjes së të akuzuarit, se i akuzuari mund të frikësonte viktimat dhe dëshmitarë dhe se mund të kryente krime të tjera nëse lihej në gjendje të lirë.⁶
3. Këto rrethana nuk kanë ndryshuar. Në fakt këto rreziqe janë rritur pasi i akuzuari është vënë në dijeni për akuzat që rëndojnë mbi të dhe pas bërjes së ditur të materialeve mbështetëse të aktakuzës dhe të provave të tjera kundër tij, në përputhje me rregullën 102(1). Për këtë arsye, vijon të jetë e nevojshme mbajtja në paraburgim e të akuzuarit.

¹ Ligji Nr. 05/L-053 “Për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar”, datë 3 gusht 2015 (“Ligji”). Nëse nuk thuhet ndryshe, nenet e përmendura janë nenet e Ligjit.

² Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev3/2020, datë 2 qershor 2020 (“Rregullorja”). Nëse nuk thuhet ndryshe, rregullat e përmendura janë rregullat e Rregullores.

³ Urdhër për parashtrime mbi rishikimin e paraburgimit, KSC-BC-2020-05/F00048, publik, 16 nëntor 2020.

⁴ Versioni publik i redaktuar i parashtrimit të Aktakuzës për konfirmim dhe i kërkesave në lidhje me të, parashtrimi KSC-BC-2020-05/F00002, datë 14 shkurt 2020, 2 tetor 2020, KSC-BC-2020-05/F00002RED, para 24(ii).

⁵ Versioni i redaktuar publik i fletarrestimit për zotin Salih Mustafa, KSC-BC-2020-05/F00009/A01/RED, 12 qershor 2020 (“Fletarrestimi”), para 1-2. *Shih edhe* Vendimin mbi kërkesën për lëshimin e fletarrestimit dhe urdhrin për transferim, 28 KSC-BC-2020-05/F00009, 12 qershor 2020.

⁶ Fletarrestimi, KSC-BC-2020-05/F00009/A01/RED, para 5.

B. RRETHANAT QË BËJNË TË NEVOJSHME MBAJTJEN NË PARABURGIM TË TË AKUZUARIT

i. Dyshimi i bazuar mirë se i akuzuari ka kryer vepra penale nën juridiksionin e DHSK-së

4. Gjatë konfirmimit të Aktakuzës kundër të akuzuarit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se ekzistonte dyshim i bazuar mirë se i akuzuari kishte kryer vepra penale që bien në juridiksionin e DHSK-së.⁷ Ky dyshim vijon të ekzistojë, duke qenë se nuk ka pasur zhvillime të tilla në këtë çështje të cilat do të kërkonin rishqyrtimin e këtij konstatimi.

ii. Rritje e rrezikut të arratisjes

5. Në fletarrestim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake shprehej se dijenia e të akuzuarit për akuzat e ngritura kundër tij dhe për dënimin e mundshëm, dijenia që ai ka për vendimet e raportuara publikisht për fajësi penale kundër komandantëve të Zonës Operative të Llapit, posti që ai mban brenda aparatit të shërbimit të inteligjencës të Kosovës dhe mundësia që ka për të udhëtuar lirisht dëshmonin se kishte motivimin dhe mjetet për t'u arratisur.⁸

6. Aktualisht, motivet e të akuzuarit për t'u arratisur janë edhe më të mëdha se në momentin e lëshimit të fletarrestimit. Të akuzuarit i janë zbuluar materialet mbështetëse të aktakuzës⁹ dhe materiale të tjera që ZPS-ja mund të vendosë t'i përdorë në gjykim.¹⁰ Rrjedhimisht, i akuzuari është në dijeni të provave kundër tij dhe të potencialit të tyre provues. Duke mbajtur në konsideratë shkallën e rëndë të akuzave të ngritura kundër tij, i akuzuari është tani në dijeni edhe të mundësisë konkrete të marrjes së një dënimi të gjatë me burgim, përfshirë edhe burgimin e përjetshëm.¹¹

⁷ Versioni i redaktuar publik i vendimit për konfirmimin e aktakuzës kundër Salih Mustafës, KSC-BC-2020-05/F00008/RED, 5 tetor 2020, parat 123, 129, 133, 138, 141, 145, 151. *Shih edhe* Fletarrestimi, KSC-BC-2020-05/F00009/A01/RED, parat 1-2.

⁸ Fletarrestimi, KSC-BC-2020-05/F00009/A01/RED, para 5.

⁹ Rregulla 102(1)(a).

¹⁰ Rregulla 102(1)(b).

¹¹ Neni 44(1).

7. Gjykatësi i Procedurës Paraprake e shikon këtë rrezik të rritur të arratisjes edhe nga këndvështrimi i vështirësive që mund të lindnin në ndjekjen e një personi të arratisur jashtë Kosovës. DHSK-ja mund të kërkojë bashkëpunimin e detyrueshëm për dorëzimin e të akuzuarit vetëm nga Kosova ose nga një vend që e njeh Kosovën dhe që ka marrëveshje ekstradimi me të ose ndonjë legjislacion tjetër mundësues.¹² Marrëveshje të tilla ka vetëm me një numër të kufizuar vendesh.¹³ Kjo situatë dallon ndjeshëm nga juridiksione të tjera dhe institucione të tjera, siç është TPNJ-ja që mund të kërkojë bashkëpunim më të zgjeruar të detyrueshëm në bazë të kompetencave të cilat ia jep Këshilli i Sigurimit i OKB-së.¹⁴ Siç shpjegohet në kërkesën për fletarrestim,¹⁵ i akuzuari nuk vuan nga ndonjë gjendje fizike apo mjekësore e cila do t'ia kufizonte mundësinë për të udhëtuar, padyshim që gëzon mundësitë për t'u larguar nga Kosova nëpërmjet kalimit të paligjshëm të kufirit po të jetë nevoja dhe mund të shkojë në një shumicë të madhe vendesh të botës, për t'iu larguar kështu në mënyrë të përhershme mundësisë për t'u kapur nga DHSK-ja.

iii. Rritja e rrezikut të ndërhyrjes te dëshmitarët dhe viktimat

8. Në fletarrestim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi arsye të artikulueshme për të besuar se i akuzuari mund të pengonte procesin duke ndërhyrë te dëshmitarët, viktimat apo bashkëkryesit.¹⁶

9. Rrethanat në të cilat mbështeteshin këto konstatime nuk kanë ndryshuar. Përkundrazi, zbulimet që i janë bërë të akuzuarit në bazë të rregullës 102(1), do t'ia kenë rritur të akuzuarit motivin, synimin dhe mundësinë për të ndërhyrë te viktimat dhe dëshmitarët.¹⁷

¹² Neni 55(2); Rregulla 208.

¹³ Ku përfshihen, sa u takon marrëveshjeve për ekstradimin, Shqipëria, Austria, Belgjika, Kroacia, Republika Çeke, Gjermania, Hungaria, Italia, Maqedonia, Turqia, Britania e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Shumica e këtyre vendeve kanë lidhur marrëveshje ekstradimi me vetë Kosovën. Të tjerat kanë rënë zyrtarisht dakord me Kosovën për vijimin e zbatimit të marrëveshjeve të ekstradimit të lidhura me Republikën Federative të Jugosllavisë.

¹⁴ Këshilli i Sigurimit i OKB-së, S/RES/827 (1993), Rezoluta 827, 25 maj 1993, para 4.

¹⁵ Kërkesë për fletarrestim, KSC-BC-2020-05/F00002RED, para 7.

¹⁶ Fletarrestimi, KSC-BC-2020-05/F00009/A01/RED, para 5.

¹⁷ *Shih* Kërkesë për fletarrestim, KSC-BC-2020-05/F00002, parat 8-11 (që janë përfshirë për referim).

10. Në veçanti, kuadri i kufizuar i kësaj çështjeje, që lidhet me një periudhë kohore dhe vendndodhje të veçantë, është me rëndësi për vlerësimin e rrezikut të identifikimit të dëshmitarëve dhe të ndërhyrjes te ta. Të akuzuarit i janë zbuluar deklarata dhe prova materiale, në bazë të rregullës 102(1), por gjykimi nuk ka filluar ende dhe dëshmitë nuk janë dëgjuar ende, çka e vendos procesin gjyqësor në një pozitë veçanërisht të cenueshme. I akuzuari është një punonjës me përvojë i shërbimit të inteligjencës,¹⁸ me njohuri teknike dhe me rrjet për identifikimin e viktimave dhe dëshmitarëve të kësaj çështjeje dhe për ndërhyrjen te ta.

iv. Rritja e rrezikut të kryerjes së krimeve nga i akuzuari

11. Siç ka konstatuar Gjykatësi i Procedurës Paraprake, mburrjet publike të të akuzuarit për ekzekutimin e serbëve në Prishtinë më 14 qershor 1999 dëshmojnë rrezikun e përdorimit prej tij të dhunës fizike ose të kërcënimit për përdorimin e dhunës fizike kundër viktimave dhe dëshmitarëve.¹⁹ I akuzuari është tashmë në dijeni të bazës solide provuese ku mbështeten akuzat e ngritura kundër tij. Ai është po ashtu në dijeni të mundësisë konkrete të dhënies kundër tij të një dënimi të gjatë me burgim. Pas këtyre zhvillimeve, rreziku që, po të lihet në gjendje të lirë, i akuzuari mund t'i kërcënojë dëshmitarët me ushtrim të dhunës fizike, veçse mund të jetë rritur.

v. Vijimi i paraburgimit është e vetmja mënyrë për administrimin e rreziqeve që vijnë nga i akuzuari

12. Në përgjithësi, rreziqet e ardhura nga lirimi i të akuzuarit, të marra veçmas apo bashkërisht, mund të administrohen në mënyrë efektive vetëm në objektin e paraburgimit. Paraburgimi është mënyra më efektive për t'ia kufizuar të akuzuarit mundësinë për t'u arratisur apo për t'iu larguar juridiksionit së DHSK-së, për ta penguar procesin hetimor apo atë gjyqësor dhe/ose për të kryer krime të tjera. Çdo garanci që mund të japë i akuzuari do të ishte e pamjaftueshme për të garantuar

¹⁸ Fletarrestimi, KSC-BC-2020-05/F00009/A01/RED, para 5.

¹⁹ Fletarrestimi, KSC-BC-2020-05/F00009/A01/RED, para 5.

përmbushjen e çdo kushti apo për të përballuar rreziqet konkrete që vijnë nga nxjerrja në gjendje të lirë. Në këto rrethana, nuk duhet të miratohet lirimi, me ose pa kushte.²⁰

C. MASA E KËRKUAR

13. Për arsyet e mësipërme, ZPS-ja i kërkon Gjykatësit të Procedurës Paraprake të japë urdhër që i akuzuari të qëndrojë në paraburgim.

Numri i fjalëve (në origjinal): 1.272

/nënshkrim/

Xhek Smith

Prokuror i Specializuar

E premtë, më 20 nëntor 2020

Hagë, Holandë.

²⁰ *Shih, për ngjashmëri, ICC, Appeals Chamber, Prosecutor v. Gbagbo, ICC-02/11-01/11-278-Red, Judgment on the appeal of Mr Laurent Koudou Gbagbo against the decision of Pre-Trial Chamber I of 13 July 2012 entitled "Decision on [...]", 26 October 2012, para.80.*